

VENDIM
Nr. 110, datë 13.2.2013

**PËR MIRATIMIN E RIALOKIMIT TË FONDEVE SIPAS MARRËVESHJES SË HUAS DHE
PROGRAMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE, E FONDIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIM DHE KfW
FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “FONDI I INVESTIMEVE
SOCIALE IV”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të nenit 26 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr. 10 407, datë 31.3.2011 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe programit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave e Fondit Shqiptar për Zhvillim, si agjenci zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Fondi i investimeve sociale IV””, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rialokimit të fondeve sipas marrëveshjes së huas dhe programit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave e Fondit Shqiptar për Zhvillim dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Fondi i investimeve sociale IV”, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha